

20080350550

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN
E LIGJIT PËR GJYKATAT

Neni 1

Në Ligjin për gjykatat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 58/2006) në nenin 31, paragrafi (2) alineja 3 shlyhet.

Neni 2

Në nenin 32 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Në Gjykatën Themelore Shkupi I - Shkup formohet seksion i specializuar gjyqësor kompetent për gjykimin e veprave nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit për tërë territorin e Republikës së Maqedonisë. Seksioni i specializuar gjyqësor është kompetent të gjykojë:

- për vepra penale të kryera nga grupi i strukturuar prej tre ose më tepër personave, i cili ekziston një periudhë kohore të caktuar dhe vepron me qëllim që të kryejë një ose më shumë vepra penale për të cilat është paraparë dënim me burg së paku prej katër vjetësh, me qëllim që në mënyrë direkte ose indirekte të përfitojë dobi financiare ose dobi tjetër;

- për vepra penale të kryera nga grupi i strukturuar ose nga organizata kriminale në territorin e Republikës së Maqedonisë ose shtete tjera ose kur vepra penale është përgatitur ose planifikuar në Republikën e Maqedonisë ose në shtet tjetër;

- për vepra penale keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit nga neni 353, paragrafi 5, marrje e mitos me vlerë më të madhe nga neni 357 dhe ndërmjetësim kundërligjor nga neni 359 të gjitha nga Kodi penal, të kryera nga funksionari i zgjedhur ose emëruar, nga personi zyrtar ose personi përgjegjës te personi juridik; dhe

- për vepra penale prodhim dhe lëshim të paautorizuar në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve nga neni 215, paragrafi 2, larje parash dhe kontribute tjera të veprës ndëshkimore me vlerë më të madhe nga neni 273, rrezikim terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë nga neni 313, dhënie e mitos me vlerë më të madhe nga neni 358; ndikim i paligjshëm te dëshmitarët nga neni 368-a, bashkim kriminel nga neni 394, organizatë terroriste nga neni 394-a, terrorizëm nga neni 394-b, vepra penale tregti e palejuar me mallra të akcizave, vepra penale tregti me njerëz nga neni 418-a, vepra penale kontrabandë me emigrantë nga neni 418-b, tregti me person të mitur nga neni 418-g, dhe për vepra tjera penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare nga Kodi penal, pa marrë parasysh numrin e kryerësve."

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Gjykatat Themelore në Manastir, Tetovë, Shkupi II - Shkup dhe Shtip janë kompetente për mbajtjen e regjistrit gjyqësor për parti politike dhe atë: Gjykata Themelore në Manastir për rajonin e Gjykatës së Apelit në Manastir, Gjykata Themelore Tetovë për rajonin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, Gjykata Themelore Shkupi II - Shkup për rajonin e Gjykatës së Apelit në Shkup dhe Gjykata Themelore Shtip për rajonin e Gjykatës së Apelit në Shtip, ndërsa Gjykata Themelore Shkupi II – Shkup për mbajtjen e Regjistrit themeltar gjyqësor të partive politike në bazë të të dhënave të marra nga gjykatat kompetente."

Neni 3

Në nenin 35, paragrafi (1), pika 6 pas fjalëve: "Republika e Maqedonisë" shtohen fjalët: "në pajtim me rregullat dhe principet e përcaktuara me Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe duke u nisur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut".

Neni 4

Në nenin 36, paragrafi (1) fjalët: "gjkata më e lartë e drejtpërdrejtë" zëvendësohen me fjalët: "Gjkata Supreme e Republikës së Maqedonisë".

Pas paragrafit (1) shtohet dy paragrafë të rinj (2) dhe (3) si vijojnë:

"(2) Kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni pala mund ta parashtrojë gjatë veprimeve para gjykatave të vendit, ndërsa më së voni gjashtë muaj duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.

(3) Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni përmban:

- të dhënat për parashtruesin e kërkesës dhe përfaqësuesin juridik;
- të dhënat për lëndën dhe procedurën për të cilën pala mendon se e ka bërë cenimin e të drejtës për gjykim në afatin e arsyeshëm;
- arsyetimin e shkaqeve për gjoja cenimin e bërë të së drejtës për gjykim në afatin e arsyeshëm;
- deklaratën për kërkesën e kompensimit të drejtë, dhe
- nënshkrimin e parashtruesit të kërkesës."

Paragrafi (2) i cili bëhet paragrafi (4), ndryshohet si vijon:

"(4) Gjykata Supreme e Republikë së Maqedonisë vepron ndaj kërkesës e cila i plotëson kriteret e përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni në afat prej gjashtë muajsh nga parashtrimi i saj dhe vendos nëse gjykata më e ulët e ka cenuar të drejtën për gjykim në afatin e arsyeshëm, duke pasur parasysh me këtë rast rregullat dhe principet e përcaktuara me Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, e veçanërisht ndërlikimin e lëndës, sjelljen e palëve në procedurë dhe sjelljen e gjykatës e cila ka vepruar."

Paragrafi (3) i cili bëhet paragrafi (5), ndryshohet si vijon:

"(5) Nëse Gjykata Supreme konstaton cenimin e të drejtës për gjykim në afatin e arsyeshëm me aktvendim do të caktojë afat në të cilin gjykata, para së cilës procedura është në rrjedhë, detyrimisht duhet të vendosë për të drejtën, obligimin ose përgjegjësinë penale të parashtruesit të kërkesës dhe do të rigjykojë kompensim të drejtë për parashtruesin e kërkesës për shkak të cenimit të së drejtës së tij për gjykim në afat të arsyeshëm."

Në paragrafin (4) i cili bëhet paragrafi (6) pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: "dhe paguhet në afat prej tre muajsh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme."

Neni 5

Pas nenit 36 shtohet neni i ri 36-a si vijon:

"36-a

(1) Pas pranimit të kërkesës nga neni 36, paragrafi (1) i këtij ligji Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej 15 ditësh do të kërkojë nga gjykata e shkallës së parë të dorëzojë kopje të shkresave nga dosja e lëndës, ndërsa sipas nevojës edhe sqarim nga gjykata më e lartë për kohëzgjatjen e procedurës para saj.

(2) Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë ndaj kërkesës nga neni 36, paragrafi (1) i këtij neni vendos në këshill prej tre gjykatësish në seancë jopublike por me përjashtim gjykata mund të vendosë t'i dëgjojë parashtruesin e kërkesës dhe përfaqësuesin e gjykatës procedura e të cilës është objekt i kërkesës së parashtruar.

(3) Kundër aktvendimit të Këshillit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, pala e pakënaqur ka të drejtë që në afat prej tetë ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit të aktvendimit t'i dorëzojë ankesë Gjykatës Supreme, e cila vendos për të njëjtën sipas nenit 35, paragrafi (1), pika 1 e këtij ligji.

Neni 6

Neni 46 ndryshon si vijon:

“(1) Kushtet e veçanta për zgjedhjen e gjykatësit janë:

- për gjykatës të gjykatës themelore mund të zgjidhet personi i cili e ka kryer stërvitjen në Akademinë për stërvitjen e gjykatësve dhe të prokurorëve publikë,
- për gjykatës të gjykatës së apelit mund të zgjidhet personi i cili ka pesë vjet përvojë pune në çështje juridike pas provimit të dhënë të jurisprudencës,
- për gjykatës të Gjykatës Administrative mund të zgjidhet personi i cili ka pesë vjet përvojë pune pas provimit të dhënë të jurisprudencës, në çështje juridike, ose është profesor universitar nga lëmi i të drejtës me shkallë shkencore doktor i shkencave juridike, dhe
- për gjykatës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë mund të zgjidhet personi i cili ka tetë vjet përvojë pune me rezultate të dëshmuara në çështje juridike pas provimit të dhënë të jurisprudencës.

(2) Për gjykatës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë mund të zgjidhet edhe profesori ordinar ose inordinar universitar i cili ka ligjëruar më shumë se dhjetë vjet lëndë juridike të lidhur me praktikën gjyqësore.”

Neni 7

Në nenin 126 paragrafi (1) ndryshon si vijon:

“Deri në marrjen e cilësisë së par të kandidatëve për gjykatës në pajtim me Ligjin për Akademinë për stërvitjen e gjykatësve dhe të prokurorëve publikë, gjykatësit e gjykatave themelore do të zgjidhen në pajtim me kushtet e nenit 43 paragrafi (1) të Ligjit për gjykatat (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 36/95, 45/95 dhe 64/2003) dhe të kenë përvojë pune me rezultate të dëshmuara në çështje juridike pas dhënies së provimit për jurisprudencë mbi tri vjet.”

Në paragrafin (2) fjalët: “neni 43 paragrafët (1) dhe (2) të Ligjit për gjykatat (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 36/95, 45/95 dhe 64/2003)” zëvendësohen me fjalët :”paragrafin 1 të këtij neni”.

Neni 8

Në nenin 127 fjalët: “paragrafët (1) dhe (2)” zëvendësohen me fjalët: “paragrafi (1)”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".